



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:201318
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05519583

C.nr.590/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, në çështjen juridiko-civile të paditësit U.Z, nga fshati Krushe e Madhe, Komuna e Rahovecit, me përfaqësues të autorizuar avokat D.M nga Prizreni, kundër të paditurës E me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen kontestimore padi për kompensim të dëmit, vlera e kontestit 1,000.00 euro, më datë 26.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET SË ËSHTË TËRHEQUR padia e paditësit U.Z, nga fshati Krushe e Madhe, Komuna e Rahovecit, kundër të paditurës E me seli në Prishtinë lidhur me çështjen kontestimore padi për kompensim të dëmit, vlera e kontestit 1,000.00 euro.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi U.Z, me përfaqësues të autorizuar avokati D.M nga Prizreni, me datë 29.09.2022 ka paraqitur në Gjykatë padi për kompensimin e dëmit, kundër të paditurës E, me seli në Prishtinë.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë për kompensimin e dëmit, gjeti se paditësi nuk e ka paguar taksën gjyqësore.

Me vërejtjen për pagesë të taksës gjyqësore C.nr.590/22 të datës 05.12.2022, kjo gjykatë e ka ftuar paditësin që në afat prej 15 ditësh, ta paguajnë taksën e paraparë gjyqësore për padinë e parashtruar, me vërejtje se në rast se të njëjtën nuk e paguan do të konsiderohet se e ka tërhequr padinë.

Në shkresat e lëndës ekziston prova – fletëkthesa, se përfaqësuesi i autorizuar i paditësit e ka pranuar aktvendimin e lartcekur, me datën 09.12.2022, dhe nuk ka vepruar brenda afatit të caktuar nga Gjykata.

Duke marrë parasysh faktin se as pas aktvendimit të dërguar nga gjykata, paditësi nuk e ka bërë pagesën e kësaj takse brenda afatit të përcaktuar, ndërsa që nuk ekzistojnë kushtet për lirimin e saj nga pagesa e të njëjtës, gjykata vendosi si në dispozitiv, e në pajtim me dispozitat e nenit 253 pika 5 të Ligjit nr.03/1-006 për Procedurën Kontestimore, në të cilin nen thuhet se: “ *Në qoftë se*

Paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr ”.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë t’i bartë këto shpenzime, është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në bazë të nenit 253 pika 5 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.590/2022, më datën 26.03.2024

Gjyqtari
Avni Berisha

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.